



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

të mbledhjes së pestë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 25.09.2017,
e cila filloi në orën 15:00.

Në mbledhje morën pjesë: Halim Halimi, kryesues i Komitetit, Agim Gashi, shef i GP të LDK-së, Besa Rafuna, përfaqësuese e LDK-së, Hatixhe Hoxha, përfaqësuese e LVV-së, Mirlinda Sopi, shefe e GP të AKR-së, Cuneyd Ustaibo, përfaqësues i subjektit politik KDTP.

Munguan: Brahim Mehmetaj, shef i GP të AAK-së, Hazir Borovci, përfaqësues i LDK-së, Lirak Çelaj, shef i GP të PDK-së, Laura Zherka, përfaqësuese e PDK-së.

Të pranishëm ishin edhe: Agim Salihu, asistent i kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Ardian Olluri, shef i Zyrës ligjore, Fatos Dibra zyrtar nga Zyra ligjore, Besart Vllahinja, drejtor i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ismail Kokaj, drejtor i Drejtorisë së Financave, Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Osman Bllaca dhe Mentor Zeka nga OSBE-ja.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Halim Halimi**, kryesues, me këtë

REND TË DITËS:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së katërt të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Propozimvendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2018 dhe shqyrtimi i Kornizës afatmesme buxhetore për periudhën 2018-2020;
3. Propozimrregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme;
4. Propozimrregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjopa komunale;
5. Shqyrtimi i raportit financiar tremujor për periudhën janar – qershor 2017;
6. Propozimi për miratimin e Planit zhvillimor të arsimit në komunën e Prishtinës 2018-2022;
7. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë ndërmarrjes publike komunale “Hortikultura”;

8. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit të memorialit përkujtimor për ushtarët britanikë të KFOR-it;
9. Propozimvendimi për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm për tërësinë urbane "B" të lagjes "Prishtina e Re - Zona Lindje";
10. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të personave fizikë;
11. Diskutim për Raportin vjetor të auditimit të pasqyrave financiare vjetore për vitin 2016;
12. Të ndryshme.

Para se të fillonin diskutimet rreth pikave të rendit të ditës, **Agim Gashi** propozoi që nga pika 1- 6 të procedohet për këtë mbledhje të Kuvendit, ndërsa nga pika 7-12 të thirret një seancë tjetër.

Ardian Olluri propozoi që pika 10 të mbetet për këtë seancë.

Halim Halimi, kryesues, shprehu mendimin se si Komitet për Politikë dhe Financa e shqyrtojmë rendin e ditës kështu siç është, pastaj në Kuvend vendosim për ndarjen eventuale të pikave edhe për një seancë tjetër.

Njëzëri u miratua rendi i ditës.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së katërt të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së katërt të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pika e dytë

Propozimvendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2018 dhe shqyrtimi i Kornizës afatmesme buxhetore për periudhën 2018-2020.

Ismail Kokaj dha sqarime lidhur me buxhetin, duke cekur se buxheti si zakonisht është punuar sipas qarkores buxhetore që caktohet nga Ministria e Financave.

Buxheti për vitin 2018 është 71,222,581 €, nga të cilat paga dhe mëditje janë paraparë 29,225,832 €, mallra dhe shërbime 13,432,732 €, shpenzime komunale 1,793,000 €, subvencione dhe transfere 1,816,810 € dhe investime kapitale 24,954,207 €.

Sa i përket kornizës afatmesme buxhetore, duhet punuare në muajin qershor, sepse limitet e kufijve nuk na vijnë, këtë radhë e kemi marrë në muajin gusht dhe kjo është arsyeja pse jemi vonuar.

Agim Gashi theksoi se te fusha e arsimit nuk është paraparë asnjë shumë për investime në infrastrukturë shkollore në ndërtimin e objekteve të reja, po ashtu edhe në dokumentin e planit zhvillimor të arsimit të Komunës së Prishtinës është e njëjta gjë.

Ai tha se e ka dëgjuar Kryetarin në një debat, duke thënë se e kemi një marrëveshje për ndërtimin e pesë objekteve shkollave, mirëpo Prishtina ka nevojë për më shumë

institucione shkollore dhe mos me pasur asnjë shumë në buxhetin përkatës dhe në planin zhvillimor për këtë gjë në këtë vit, nuk po më duket racionale. Nëse dikush ka shpjegim për këtë punë, atëherë le të na e shpjegojë.

Genc Bashota dha sqarime, duke cekur se është një koncept i ndërtimit të shkollave me partneritet publiko-privat. Ne e kemi nënshkruar marrëveshjen me ta, e në këtë rast operatori privat do ta bëjë ndërtimin e 5 shkollave në komunën e Prishtinës, janë ndarë lokacionet dhe kjo do të ndodhë në vitin e ardhshëm, kështu që vitin e ardhshëm nuk iu paguhet atyre kurrfarë rate nëse hyjmë në marrëveshje. Do të jenë 2 vjet që ne nuk do të kemi nevojë të ndajmë buxhet nëse hyjmë, e ne do të hyjmë në këtë operacion. Atëherë kjo zgjatë diku, sipas fizibilitetit, 15 vjet afati i pagesës karshi atyre që i kanë ndërtuar shkollat. Kjo është arsyeja pse në vitin e ardhshëm nuk është në buxhet, e shkollat fillojnë të ndërtohen në tetor të vitit të ardhshëm. Ai që ndërton është i obliguar, në bazë të kontratës së tillë, që përveç ndërtimit ta bëjë edhe mirëmbajtjen.

Mirlinda Sopi pyeti se si do ta kompensojë këtë Komuna.

Genc Bashota tha se Komuna për çdo muaj ia paguan, mirëpo në këtë vit kryetari nuk e ka paraparë, sepse nuk ka nevojë, kjo fillon prej vitit të ardhshëm.

Ardian Olluri shprehu mendimin se ky model është shumë adekuat për shkolla.

Mirlinda Sopi shprehu shqetësimin për buxhetin e vogël që po i ndahet Drejtorisë së Shëndetësisë dhe për këtë kërkoi sqarim nga drejtori i Drejtorisë së Financave.

Ismail Kokaj tha se buxheti për vitin 2018 në shëndetësi është ngritur, është pak, por është maksimumi që e sjellin nga Ministria.

Mirlinda Sopi pyeti se a mund të bëjë Komuna diçka në këtë drejtim.

Ismail Kokaj tha se Komuna nuk ka mundësi ta rritë buxhetin, buxheti vjen i gatshëm nga Ministria.

Agim Gashi tha se edhe në kulturë, për restaurimin e objekteve kulturore, nuk ka asnjë shumë të planifikuar në buxhet.

Besart Vllahinja, sa i përket buxhetit të Drejtorisë së Kulturës, tha se në këtë vit ne kemi ndjekur një praktikë bashkë me institucionet varëse të Drejtorisë së Kulturës, për të prezantuar një buxhet të detajuar, ku në Kuvend do ta elaborojë më detajisht. Risi në këtë plan buxhetor për vitin 2018 është Galeria e Artit, e paraparë 1,350,000 €, po ashtu kemi implementimin e standardit për siguri dhe mbrojtje të lëndës arkivore, e paraparë 150,000 €, renovimi i objekteve të trashëgimisë kulturore, e paraparë 600.000 €, kompjutera për institucione kulturore, ku na mungojnë, po ashtu nga kategoria “mallra dhe shërbime” kemi planifikuar projektet që synojnë ngritjen e kapaciteteve të stafit të Drejtorisë së Kulturës.

Hatixhe Hoxha u pajtua që kjo të procedohet për Kuvend dhe atje të diskutohet.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2018 dhe shqyrtimi i Kornizës afatmesme buxhetore për periudhën 2018-2020 dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e tretë

Propozimrregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme.

Ismail Kokaj bëri të ditur se në këtë rregullore nuk ndryshon asnjë çmim apo diçka tjetër, vetëm janë korrigjimet e gabimeve teknike që kemi mundur t'i plotësojmë.

Agim Gashi tha se në zonën e parë është shtuar rruga "2 Korriku", që më herët ka qenë në zonën e pestë, dhe për këtë kërkoi sqarim se a është gabim teknik, apo ka ndonjë arsyetim.

Ismail Kokaj sqaroi se është gabim teknik, ku me emërtimin e ri të rrugëve rruga "2 Korriku" ka mundur me qenë në një pjesë tjetër të qytetit, kur ka ardhur si rrugë e re ka hyrë në zonën e parë, fizikisht ka ndërruar rruga komplet.

Agim Gashi u shpreh se më gjerësisht do të diskutojmë në Kuvend, sepse kjo rregullore ka ndryshime esenciale në shumë pozicione tatimore, ku nëse nxirret një mesatare, del se mesatarja e lirit të tatimit në pronën e paluajtshme zbret mbi 50%, po shihen dallime të mëdha.

Ismail Kokaj tha se mund t'i marrim dhe t'i shikojmë rregulloren e vjetër dhe rregulloren e re dhe t'i shohim dallimet.

Agim Gashi pyeti se a është ndryshuar taksa në objektet e banimit.

Ismail Kokaj bëri të ditur se te objektet e banimit nuk ka ndryshuar taksa.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimrregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e katërt

Propozimrregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale.

Ismail Kokaj dha sqarime lidhur me këtë propozimrregullore, duke cekur se ka një paragraf që nuk ka qenë i qartë në Rregulloren e vjetër, është marrë dhe është zbërthyer, disa probleme që i kemi hasur gjatë praktikës së përditshme, kështu që edhe Rregullorja që do të jetë gjatë praktikës, prapë në vitet e ardhme duhet qartësuar edhe pikat tjera, këto janë vetëm ato që kemi mundur t'i identifikojmë në vitet e fundit.

Agim Gashi u pajtua me mendimin se është bërë një zbërthim i kuptimit të përgjysmuar të nenin 4 të rregullores.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimrregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e pestë

Shqyrtimi i raportit financiar tremujor për periudhën janar – qershor 2017.

Ismail Kokaj dha sqarime lidhur me raportin financiar tremujor për periudhën janar – qershor 2017. Ai tha se një çështje që e kemi diskutuar edhe më herët, është se në procedura parashihet që për

raportin tremujor duhet të raportohet. Ne këtu e kemi qitur të njëjtin raport tremujor buxhetor janar – qershor, se nuk mund të raportojmë për vetëm një raport tremujor, d.m.th. merret tremujori i parë, tre mujori i dytë, e mandej tremujori i tret prapë është një periudhë nëntë mujore, derisa të vijmë në fund të një raport final.

Agim Gashi tha se në aspektin ekonomik nuk e di cila gjuhë e përkufizon, por në aspektin komunikues kjo nuk është në rregull, ose duhet thënë raport gjashtëmujor, ose raport tre mujor janar-shkurt- mars dhe prill-maj-qershor, por të ndahet në dy pjesë.

Ismail Kokaj theksoi se nga ana ekonomike ceket tremujori i dytë.

Mirlinda Sopi tha se edhe në qershor ka qenë tremujori i dytë.

Halim Halimi, kryesues, theksoi se ky raport që e kemi këtu është gjashtëmujor, për tremujor është dashur të jetë janar-shkurt-mars, dhe për të të raportohet në fillim të prillit.

Agim Gashi u shpreh i pajtimit që ky raport të quhet raport gjashtëmujor e jo tremujor, sepse me ligj je i obliguar me raportuar çdo gjashtë muaj.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Shqyrtimi i raportit financiar tremujor për periudhën janar – qershor 2017 dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e gjashtë

Propozimi për miratimin e Planit zhvillimor të arsimit në komunën e Prishtinës 2018-2022.

Agim Gashi tha se në Kuvend do të diskutojmë lidhur me këtë pikë, mirëpo do të duhej dikush të referonte për krahasimet në mes të planit zhvillimor të kaluar dhe këtij që e kemi tani, se çka atëherë nuk është realizuar, çka tash është planifikuar dhe të bëhen krahasime.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimi për miratimin e Planit zhvillimor të arsimit në komunën e Prishtinës 2018-2022 dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e shtatë

Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë ndërmarrjes publike komunale “Hortikultura”.

Halim Halimi, kryesues, kërkoi sqarime nga Zyra ligjore lidhur me dhënë e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë në këtë periudhë.

Fatos Dibra tha se nuk është problem dhënia e pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë, sepse janë disa raste të veçanta, e kjo hynë në rastet e veçanta, ndërsa afati nuk prishë punë.

Agim Gashi theksoi se ky nuk është rast i veçantë, mund të jepet në shfrytëzim për 15 vjet e të mos e kthen Ministria se nuk është rast i veçantë.

Fatos Dibra theksoi se nëse nuk është rast i veçantë, atëherë nuk mund t’ia japim as për 15 vjet, por duhet shkuar në procedura të rregullta në ankand publik, duhet me proceduar në procedura të konkurrimit.

Ardian Olluri bëri të ditur se për rastet të veçanta, për procedurë të veçantë pa shkuar në procedurë të konkurrimit, nuk ka kufizim për shfrytëzim afatgjatë sipas shkresës së Ministrisë që e kemi marrë.

Halim Halimi, kryesues, kërkoi që të shqyrtohet deri në seancën e Kuvendit, në mënyrë që të mos e kthejë Ministria si të paligjshme.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë ndërmarrjes publike komunale "Hortikultura" dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e tetë

Propozimvendimi për caktimin e lokacionit të memorialit përkujtimor për ushtarët britanikë të KFOR-it.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për caktimin e lokacionit të memorialit përkujtimor për ushtarët britanikë të KFOR-it dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e nëntë

Propozimvendimi për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm për tërësinë urbane "B" të lagjes "Prishtina e Re - Zona Lindje".

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm për tërësinë urbane "B" të lagjes "Prishtina e Re - Zona Lindje" dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e dhjetë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të personave fizikë.

Ardian Olluri dha sqarime lidhur me këtë pikë, duke cekur se është fjala për tri raste të këmbimit të pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të personave fizikë. Rasti i parë është këmbimi me pronën e z. Mentor Vitija, ku kemi një pronë komunale që gjendet afër rrugës ekzistuese, e cila shtrihet në pronë private, e trotuari gjendet në pronë komunale. Rasti i dytë është këmbimi i pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës me pronën e znj. Shpresa Etemi, ku në pronën e saj është planifikuar rruga "A" në zonën "Mati 1", ndërsa prona komunale gjendet brenda bllokut, që ka bërë kërkesë për ndërtim znj. Shpresa Etemi. Rasti i tretë është këmbimi i pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të EKN "Invest Group", me qëllim të realizimit të Planit rregullues "Lakërishte".

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të personave fizikë dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e njëmbëdhjetë

Diskutim për Raportin vjetor të auditimit të pasqyrave financiare vjetore për vitin 2016.

Ismail Kokaj tha se prej 39 komunave që auditohen në Kosovë, vetëm një komunë ka dalë më mirë se Komuna e Prishtinës, se 90% e kanë një opinion të njëjte të auditimit, e ajo është Komuna e Vitisë. Raportin e auditimit unë e marrë si recetë, së cilës duhet përmbajtur. Është mirë me iu përmbajtur, në mënyrë që të mos na jepen vërejtjet e njëjta, përveç shpenzimeve që bëhen në kode jo adekuate e të tjera, është mirë që të mos bëhen gjetjet e njëjta çdoherë.

Besart Vllahinja ceku edhe çështjen e nëntë të ngritur nga auditori, që është një gjetje e cila është prekur edhe më herët dhe vazhdon ende. Këtë vit është zgjidhur ky problem, mjetet të cilat janë derdh në llogari të bankës komerciale, tash ato derdhen në llogari unike në thesarin që ekziston në Komunën e Prishtinës. E gjetura teatri "Dodona" dhe biblioteka "Hivzi Sulejmani" menaxhojnë financat e tyre në kundërshtim me ligjin për menaxhimin e financave publike, Rregulloren e shpenzimeve, si dhe në kundërshtim me Rregulloren e të hyrave. Këto dy institucione vartëse komunale mbledhin dhe shpenzojnë të hyrat përmes llogarive të tyre bankare dhe në disa raste edhe me para në dorë. Mjetet, suvencionet e ndara më herët që janë derdhur nëpër këto nuk kalojnë tash nëpër atë procedurë, sepse derdhja e mjeteve të subvencioneve nuk garanton zbatimin e ligjit të prokurimit publik, sepse prokurimet publike janë të detyruara, dhe e kemi ndalur një praktikë të derdhjes së mjeteve në atë llogari.

Agim Gashi konstatoi se vërehen disa përmirësime të raportit paraprak në krahasim me raportin e viti të kaluar, mirëpo ajo që bën përshtypje është mosfunksionimi i auditorit të brendshëm. Nëse auditori i brendshëm nuk funksionon, nuk është në rregull me administratën.

Halim Halimi, kryesues, sa i përket raportit të auditorit, ka të gjetura shkelje të rënda, si p.sh. 276 kontrata pa procedurën e nevojshme të rekrutimit, d.m.th. mos pranimi i punëtorëve sipas procedurave të parapara për shërbimin civil është shkelje e rëndë, kemi shkelje të shpenzimeve kapitale, të kolektorët etj.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah diskutimi për Raportin vjetor të auditimit të pasqyrave financiare vjetore për vitin 2016 dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e dymbëdhjetë

Të ndryshme

Besa Rafuna theksoi se neve si Komision komunal i aksionarëve, na ka ardhur një shkresë nga Këshilli Prokurorial i Kosovës, për shkak të kërkesës për shitjen e objektit (Ndërmarrjes

Banesore). Ju e dini se si Komision komunal i aksionarëve asnjëherë nuk kemi pasur qasje në objekte, andaj këtë kërkesë ia dërgojmë Zyrës ligjore të merret me këtë çështje.

Mbledhja përfundoi në orën 16:30.

Procesmbajtësja
Shyhrete Islami

Kryesuesi i Komitetit
Halim Halimi, jur. i dipl.